

UDHËZIM
Nr. 11, datë 4.6.2026

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE
ADMINISTRATIVE NË RASTET E SHKELJEVE NË SEKTORIN E PESHKIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 128, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim miratimin e metodologjisë që siguron zbatimin e drejtë, të qartë dhe të unifikuar të masave administrative ndaj shkeljeve të dispozitave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, në sektorin e peshkimit, duke krijuar një sistem të drejtë dhe transparent për adresimin e kundërvajtjeve.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet nga inspektorati që mbulon fushën e peshkimit në Republikën e Shqipërisë.
2. Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen për të gjitha subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitet në sektorin e peshkimit, transportit, tregtimit dhe përpunimit të produkteve të peshkimit.

Neni 3
Parimet

1. Metodologjia për përcaktimin e masave administrative bazohet në parimet si më poshtë:
Përshtatshmëria: Përcaktimi i vlerës së masës administrative duhet të pasqyrojë seriozitetin e shkeljes dhe dëmin e shkaktuar.
2. Transparenca: Procesi i vendosjes së gjobave duhet të bazohet në kritere të qarta dhe të dokumentuara, për të shmangur subjektivizmin dhe keqkuptimet.
3. Përputhshmëria: Harmonizimi i praktikave midis inspektorëve për të siguruar një zbatim të barabartë të ligjit.
4. Qartësia: Metodologjia ndihmon në shmangien e paqartësive midis subjekteve dhe inspektorëve, duke krijuar besim në sistemin e drejtësisë administrative.

Neni 4
Kriteret për përcaktimin e masës administrative

Përcaktimi i masës administrative të parashikuar në këtë udhëzim është vendosur mbi kriteret:

- a) natyrën dhe rëndësinë e shkeljes;
- b) shkallën e dëmit ekonomik dhe mjedisor të shkaktuar;
- c) sasinë e zënieve ose të produkteve objekt shkeljeje;
- ç) përsëritjen e shkeljes nga i njëjti subjekt;

- d) shkallën e bashkëpunimit të subjektit gjatë kontrollit;
- dh) faktin nëse shkelja është kryer në zona të mbrojtura ose mbi specie të mbrojtura;
- e) përfitimin ekonomik të realizuar ose të synuar nga shkelja;
- ë) çdo rrethanë tjetër rënduese ose lehtësuese të konstatuar gjatë procedurës administrative.

Neni 5

Rastet e moszbatimit të metodologjisë

1. Metodologjia e përcaktuar në këtë udhëzim zbatohet vetëm për ato masa administrative për të cilat ligji parashikon interval vlerash ose lë hapësirë vlerësimi për organin administrativ.

2. Për shkeljet administrative të parashikuara në nenin 128, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, për të cilat është përcaktuar masë administrative me vlerë fikse, zbatohet drejtpërdrejt masa e përcaktuar në ligj, pa aplikuar kriteret e metodologjisë së këtij udhëzimi.

Neni 6

Detajimi i masave administrative

Detajimi i masave administrative sipas parashikimeve të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, bëhet si më poshtë:

1. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “ç”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi i peshqve të paarrirë:

- a) Për peshqit e zënë të paarrirë nga 10–20% e totalit të zënieve: gjoba 100,000 lekë;
- b) Për peshqit e zënë të paarrirë nga 20–30% e totalit të zënieve: gjoba 300,000 lekë;
- c) Për peshqit e zënë të paarrirë nga 30–40% e totalit të zënieve: gjoba 700,000 lekë;
- d) Për peshqit e zënë të paarrirë mbi 40% e totalit të zënieve: gjoba 1,000,000 lekë.

2. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “dh”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Për shkeljet që lidhen me hedhjen apo shfrytëzimin e rërës ose zhavorrit, shkarkimin apo zhvendosjen e ujërave ose të materialeve të tjera ndotëse, si dhe ndërhyrjen, prishjen apo shkatërrimin e mjedisit në zonat e mbrojtura ujore:

- a) Nëse shkelja ka shkaktuar dëmtim të lehtë mjedisor dhe pa pasoja të konsiderueshme në habitatin ujor: gjoba 400,000 lekë;
- b) Nëse shkelja ka sjellë ndotje të konsiderueshme, dëmtim të habitatit, cenim të biodiversitetit ose depozitim materialeve ndotëse në sipërfaqe të konsiderueshme: gjoba 1,000,000 lekë;
- c) Nëse shkelja ka shkaktuar dëmtim të rëndë ose të pakthyeshëm të habitatit ujor, ndotje masive, shkatërrim të ekosistemit: gjoba është 1,500,000 lekë. Nëse shkelja është në mënyrë të përsëritur: gjoba 2,000,000 lekë.

3. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “e”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Ndërtimi i strukturave në kundërshtim me legjislacionin në zonat e mbrojtura ujore:

- a) Ndërtimi i strukturave të përkohshme ose lehtësisht të çmontueshme në tokë ose në ujë, pa autorizimin përkatës: gjoba 600,000 lekë;
- b) Ndërtimi i strukturave fikse që cenojnë habitatin natyror, aksesin ose funksionimin e zonës së mbrojtur ujore: gjoba 1,500,000 lekë;
- c) Ndërtimi i porteve, platformave, argjinaturave, strukturave industriale ose çdo ndërtim tjetër që shkakton dëmtim të rëndë të ekosistemit ujor ose ndryshim të karakteristikave natyrore të zonës së mbrojtur: gjoba 3,000,000 lekë.

4. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “f”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi në kundërshtim me urdhrin për ndalimin e peshkimit:

- a) Sasi peshqish nën 5 kg: gjoba minimale 200,000 lekë;

- b) Sasi peshqish 5 deri në 10 kg: gjoba nga 200,000 deri në 500,000 lekë;
 - c) Sasi peshqish 10–15 kg: gjoba 500,000 deri në 700,000 lekë;
 - d) Sasi peshqish mbi 15 kg: gjoba maksimale 1,000,000 lekë;
5. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “g”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi i peshqve të zënë në kundërshtim me urdhrin për ndalimin e peshkimit:
- a) Sasi peshqish nën 2 kg: gjoba minimale 100,000 lekë;
 - b) Sasi peshqish 2 deri në 5 kg: gjoba nga 250,000 deri në 350,000 lekë;
 - c) Sasi peshqish mbi 5 kg: gjoba maksimale 500,000 lekë.
6. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “h”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Përdorimi i substancave dhe mjeteve të ndaluara për peshkim:
- a) Përdorimi i substancave toksike, narkotike dhe gërryese, pajisjeve që gjenerojnë shkarkime elektrike, eksplozivëve dhe substancave të tjera: gjoba 2,500,000 lekë;
 - b) Përdorimi i mjeteve për mbledhjen e koralit të kuq dhe llojeve të tjera të koraleve dhe organizmave të ngjashëm: gjoba 1,500,000 lekë;
 - c) Përdorimi i rrjetave fundore mbledhëse me madhësi hapjeje më të vogël se 40 mm për peshkarexha: gjoba 500,000 lekë.
7. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “m”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Aktivitet peshkimi nga anije të huaja:
- a) Anijet e huaja me fuqi motorrike nën 224 kw: gjoba 3,000,000 lekë;
 - b) Anijet e huaja me fuqi motorrike nga 225–500 kw: gjoba deri në 4,000,000 lekë;
 - c) Anijet e huaja me fuqi motorrike mbi 500 kw: gjoba maksimale 5,000,000 lekë.
8. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “n”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Aktivitet peshkimi nga anije të huaja në zonën ekskluzive ekonomike të Shqipërisë pa leje:
- a) Anijet e huaja me fuqi motorrike nën 224 kw: gjoba 200,000 lekë;
 - b) Anijet e huaja me fuqi motorrike nga 225–500 kw: gjoba deri në 400,000 lekë;
 - c) Anijet e huaja me fuqi motorrike mbi 500 kw: gjoba maksimale 600,000 lekë.
9. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “nj”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Zënia e specieve të mbrojtura
- a) Korani i lumit (*Salmo letnica* lumi): gjoba 100,000 lekë;
 - b) Koralet (*Corallium spp.*): gjoba 1,000,000 lekë;
 - c) Trofta (*Salmo trutta magrostigma*, *Salmo marmoratus*): gjoba 300,000 lekë;
 - d) Blinjtë (*Acipenser sturio*, *Acipenser naccarii*): gjoba 1,000,000 lekë;
 - e) Peshkaqenët dhe rajat: gjoba 1,000,000 lekë;
 - f) Lopa e detit (*Mobula*): gjoba 700,000 lekë;
 - g) Gurëshpuesi (*Lithophaga lithophaga*): gjoba 1,000,000 lekë;
 - h) Sfungenjtë (*Spongidae*): gjoba 1,000,000 lekë;
 - i) Gjitarët e detit (balenat, delfinët, fokat): gjoba 1,000,000 lekë;
 - j) Breshkat e detit (*Carretta carretta*, *Chelonia mydas*, *Dermochelys coreacea*): gjoba 1,000,000 lekë;
 - k) Breshkat e ujit të ëmbël (*Emys orbicularis*, *Mauremys caspica*): gjoba 500,000 lekë;
 - l) Zogjtë detarë: gjoba 500,000 lekë;
 - m) Molusqe bivalvore (*Pinna nobilis*, *Pholas dactylus*): gjoba 700,000 lekë;
 - n) Iriq deti (*Centrostephanus longispinus*): gjoba 500,000 lekë.
10. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “o”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mbajtja dhe tregtimi i pendëve të peshkaqenëve:
- a) Sasia e pendëve nën 2 kg: gjoba 100,000 lekë;
 - b) Sasia 3–5 kg: gjoba 300,000 lekë;
 - c) Sasia mbi 5 kg: gjoba 500,000 lekë.

11. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “q”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Përdorimi i eksplozivëve dhe substancave të tjera për peshkim:

- a) Sasi peshku nën 2 kg: gjoba 100,000 lekë;
- b) Sasi peshku 2–5 kg: gjoba 300,000 lekë;
- c) Sasi peshku mbi 5 kg: gjoba 500,000 lekë.

12. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “xh”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mosdeklarimi i zënieve të peshkimit:

- a) Mosdeklarimi për herë të parë: gjoba 5,000 lekë;
- b) Mosdeklarimi i përsëritur: gjoba 10,000 lekë.

13. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “y”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi mbi normat e lejuara:

- a) Sasi deri 20 kg: gjoba 50,000 lekë;
- b) Sasi 20–50 kg: gjoba deri në 80,000 lekë;
- c) Sasi mbi 50 kg: gjoba deri në 100,000 lekë.

14. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “z”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mosinstalimi i sistemit të monitorimit në anije:

- a) Mosdeklarimi për herë të parë: gjoba 50,000 lekë;
- b) Mosdeklarimi i përsëritur: gjoba 100,000 lekë.

15. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “zh”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Transbordimi i zënieve në vende të pamiratuara:

- a) Shkelja për herë të parë: gjoba 10,000 lekë;
- b) Shkelja e përsëritur: gjoba 50,000 lekë.

16. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “dd”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mosparaqitja e certifikatës së origjinës së produkteve peshkore:

- a) Shkelja për herë të parë: gjoba 50,000 lekë;
- b) Shkelja e përsëritur: gjoba 100,000 lekë.

17. Shkelja e përcaktuar në shkronjën “ee”, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Përdorimi i veglave jo të autorizuar:

- a) Kurthe: gjoba 100,000 lekë;
- b) Vegla stacionare: gjoba 300,000 lekë;
- c) Vegla jo stacionare: gjoba 500,000 lekë.

Neni 7

Dispozita e fundit

1. Ngarkohet Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit për zbatimin e këtij udhëzimi. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla